



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.129

11 dhjetor

2006

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr.787, datë 16.11.2006	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim, të komunës Fushë-Bulqizë të qarkut të Dibrës.....	5101
Vendim i KM nr.788, datë 16.11.2006	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Gradishtë të qarkut të Fierit.....	5102
Vendim i KM nr.789, datë 16.11.2006	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Delvinë të qarkut të Vlorës.....	5103
Udhëzim i MB nr.3071, datë 11.12.2006	Për procedurat dhe afatet e hartimit të listave të zgjedhësve “Për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të datës 20 janar 2007”.....	5104
Vendim i ERE nr.81, datë 27.11.2006	Për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga “Amal” sh.p.k. për periudhën 1 janar 2005 deri në 31 dhjetor 2005.....	5105
Vendim i ERE nr.82, datë 27.11.2006	Për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga “Amal” sh.p.k. për periudhën 1 janar 2006 deri në 31 dhjetor 2006.....	5106
Vendim i ERE nr.83, datë 27.11.2006	Për licencimin e “Energo Sas” sh.p.k. për ndërtimin, instalimin dhe prodhimin e energjisë nga Hec Sasaj.....	5106

Ndreqje	5108
gabimi.....	

VENDIM
Nr.787, datë 16.11.2006

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS FUSHË-BULQIZË, TË QARKUT TË DIBRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Fushë-Bulqizë, të qarkut të Dibrës, sipas lidhjes 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ të komunës Fushë-Bulqizë, miratuar me vendimin nr.727, datë 23.11.2005 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Fushë-Bulqizë, të qarkut të Dibrës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Fushë-Bulqizë për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Fushë-Bulqizë

Lidhja 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-6	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
7-9	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
10-12	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive kulturore	Në pronësi
13-44	Varrezat publike	Në pronësi
45-50	Prona që përdoren për zhvillim ekonomik	Në pronësi
51-54,59,60,61,62,65,66,70,71	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë	Në përdorim
55-58,63,64,67,68,69,72-74	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit toka joproductive	Në pronësi
76-323	Pyje dhe kullota	Në pronësi
330-506	Infrastrukturë (rrugë vendore)	Në pronësi
507-509	prona që shërbejnë për furnizimin me ujë të pijshëm, ujësjellësa	Në pronësi

VENDIM
Nr.788, datë 16.11.2006

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS GRADISHTË, TË QARKUT TË FIERIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Gradishtë, të qarkut të Fierit, sipas lidhjes 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të komunës Gradishtë, miratuar me vendimin nr.131, datë 11.3.2004 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit, të qarkut të Fierit, të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Gradishtë”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Gradishtë për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Gradishtë
Lidhja 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-12	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
13-16	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
17-21	Prona që përdoren në fushën kulturore sportive	Në pronësi
22-38	Shërbim funeral	Në pronësi
39	Infrastrukturë	Në pronësi
9-23;185;186	Infrastrukturë (troje të lira)	Në përdorim
40-45,47-56,60; 62-64,66	Prona që përdoren në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
68-98	Prona që përdoren për mbrojtjen civile	Në pronësi
99-126	Pyje kullota	Në pronësi
129-141;176-184	Infrastrukturë (rrugë vendore)	Në pronësi
187-195	Sistemi i furnizimit me ujë të pijshëm	Në pronësi
143;145;147;149;151;153;154; 158;159;160;163;167;168;169-175;215; 220;235;242;247;261; 271; 275	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka jo produktive)	Në pronësi
142;144;146;148;150;152;155; 156;157;161;162;164; 165;166	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim

VENDIM
Nr.789,datë 16.11.2006

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE,
SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË BASHKISË
DELVINË, TË QARKUT TË VLORËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Delvinë, të qarkut të Vlorës, sipas lidhjes 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj bashkie, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të bashkisë së Delvinës, miratuar me vendimin nr.161, datë 25.3.2005 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në bashkinë Delvinë të qarkut të Vlorës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia e Delvinës për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Delvinë
Lidhja 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-3,5-7,9-12,14-15,20-22	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë (toka produktive)	Në përdorim
4,8,13,16-19,23,52	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë (toka jo produktive kanale të treta)	Në pronësi
24-35,108,109	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
80,84	Prona që përdoren në fushën e funksioneve administrative	Në pronësi
89-94,96-101	Prona që përdoren në fushën e arsimit	Në pronësi
105-107	Prona që përdoren në fushën kulturore e sportive	Në pronësi
110	Prona që përdoren në fushën sociale	Në pronësi
111	Shërbim funeral	Në pronësi
118-172-198	Infrastrukturë dhe shërbime publike	Në pronësi
219-278	Pyje kullota	Në pronësi

UDHËZIM
Nr.3071, datë 11.12.2006

PËR PROCEDURAT DHE AFATET E HARTIMIT TË LISTAVE TË ZGJEDHËSVE “PËR

ZGJEDHJET E ORGANEVE TË QEVERISJES VENDORE TË DATËS 20 JANAR 2007”

Në zbatim të nenit 102, pika 4, dhe 153 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të dekretit të Presidentit të Republikës nr.5131, datë 2.12.2006 “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore”, nenit 55, 59, pika 2, 60, 60/1, dhe nenit 61 të ligjit 9087, datë 19.6.2003 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, vendimit nr.129, datë 8.12.2006 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve “Për caktimin e afateve për dërgimin, përditësimin, miratimin dhe shpalljen e listave përfundimtare, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe kryetarët e njësive të qeverisjes vendore, për zgjedhjet në organet e qeverisjes vendore të datës 20 janar 2007” dhe vendimit nr.130, datë 8.12.2006 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve “Për caktimin e afatit të dërgimit të informacionit mbi numrin e qendrave të votimit, vendndodhjen e tyre dhe numrin e zgjedhësve në listën përfundimtare të zgjedhësve”,

UDHËZOJ:

1. Zyrat e gjendjes civile në njësitë e qeverisjes vendore kryejnë përditësimin e listave të zgjedhësve, brenda 10 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi, sipas përcaktimeve të nenit 55 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, bazuar në të dhënat e regjistrave themeltarë.

2. Brenda 24 orëve nga përfundimi i përditësimit, kryetarët e NJQV-ve i dërgojnë listat e zgjedhësve të përditësuar, një kopje e tyre në format elektronik, në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile (DPGJC).

3. DPGJC-ja kontrollon dublimet në shkallë vendi në listat e përditësuar dhe u kthen, brenda 4 ditëve, përgjigje me shkrim kryetarëve të NJQV-ve. Në përgjigjen e saj DPGJC-ja evidenton, për çdo regjistrim të dy apo shumëfishtë, njësitë e qeverisjes vendore ku është regjistruar zgjedhësi dhe datën e regjistrimit në regjistrin themeltar për secilën nga njësitë e qeverisjes vendore. DPGJC-ja u kërkon njësive ku zgjedhësi ka regjistrimin më të hershëm ta heqin zgjedhësin nga lista e tyre e zgjedhësve, si dhe të kryejnë procedurat për çregjistrimin nga regjistrat themeltarë të gjendjes civile.

4. Kryetari i NJQV-së, pasi ka marrë vendim për heqjen e dublimeve, jo më vonë se data 26 dhjetor 2006, miraton dhe shpall listat përfundimtare të zgjedhësve për çdo QV. Listat përfundimtare shpallen pranë zyrave të njësisë përkatëse dhe pranë çdo qendre votimi duke u vendosur në mjedise publike me hyrje të lirë për shtetasit, si rregull në vendet e përdorura edhe më parë për shpalljen e listave.

5. Kryetarët e NJQV-ve pas shpalljes së listës përfundimtare i dërgojnë këto lista në KZQV-në e njësisë së tyre të qeverisjes vendore dhe në DPGJC, sipas modeleve të përcaktuara në nenin 59 pika 2 të Kodit Zgjedhor.

6. Kryetari i NJQV-së, menjëherë pas shpalljes së listës përfundimtare të zgjedhësve, por jo më vonë se data 10 janar 2007, kryen lajmërimin me shkrim për çdo zgjedhës të përfshirë në listat përfundimtare, me anë të grupeve dyshe të punës të ngritura për çdo qendër votimi, sipas kësaj procedure:

- Lajmërimi i shtetasve kryhet nga grupet dyshe të punës, të formuara nga një përfaqësues i administratës dhe një përfaqësues i caktuar nga partia më e madhe në opozitë me kryetarin e bashkisë, komunës apo njësisë bashkiake.

- Jo më vonë se 2 ditë nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi, kryetari i kërkon partisë më të madhe opozitare në NJQV-në e tij të caktojë personat që do të marrin pjesë në grupet dyshe të punës për çdo QV. Jo më vonë se 5 ditë nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi, partia duhet të këtë dorëzuar listën e personave që do të marrin pjesë në grupet dyshe të punës.

- Me vendim, brenda 10 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, kryetari bën caktimin e grupeve dyshe të punës për çdo qendër votimi. Lajmërimi mund të kryhet edhe vetëm nga përfaqësuesi i administratës së NJQV-së nëse partia politike nuk respekton afatet e caktuara në këtë udhëzim, kur ajo është njoftuar me shkrim nga kryetari.

- Zyrat e gjendjes civile i vënë në dispozicion çdo grupi lajmërimet përkatëse dhe listën përfundimtare të zgjedhësve të QV-së përkatëse jo më vonë se 26.12.2006.

- Grupet e punës kryejnë njoftimin për çdo familje që ndodhet në listën përfundimtare të

zgjedhësve të qendrës së tyre të votimit. Kryefamiljari, ose një person madhor i familjes, firmos në listën e zgjedhësve kur merr njoftimin. Në rast se nuk kontaktohen për herë të parë, grupi i punës lë një shënim për lajmërimin tjetër dhe shkon edhe një herë për ta njoftuar. Kryetari informohet çdo ditë për lajmërimin e zgjedhësve dhe dërgon informacion në prefekturë mbi ecurinë e procesit të lajmërimit.

7. Ndryshimet në lista pas shpalljes së listës përfundimtare bëhen në përputhje me nenin 60 të Kodit Zgjedhor.

8. Në përputhje me ligjin nr.9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 61, me kërkesë të partive politike, kryetari i njësive të qeverisjes vendore vë në dispozicion të tyre kopje të listës jo më vonë se tri ditë nga paraqitja e kërkesës prej tyre.

9. Në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.337, datë 31.5.2006 “Për një shtesë fondi Ministrisë së Brendshme për mbulimin e shpenzimeve të përgatitjes së listave paraprake të zgjedhësve për zgjedhjet në organet e pushtetit vendor...”, dhe fondet e vëna në dispozicion, kryetari urdhëron mbulimin e shpenzimeve për proceset e përditësimit dhe shpalljes së listës të zgjedhësve, vënies në dispozicion të partive politike dhe subjekteve zgjedhore një kopje të listës pa pagesë, si dhe njoftimin me shkrim të familjeve që ndodhen në listën e zgjedhësve të njësive vendore përkatëse.

10. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I BRENDSHËM
Sokol Olldashi

VENDIM
Nr.81, datë 27.11.2006

**PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA “AMAL”
SHPK PËR PERIUDHËN 1 JANAR 2005 DERI NË 31 DHJETOR 2005**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2 germa b, 9 dhe 26 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe vendimit nr.60, datë 29.12.2004 të Bordit të Komisionerëve “Për miratimin e të dhënave bazë në lidhje me aplikimin për çmimin e shitjes së energjisë elektrike nga prodhuesit e vegjël”, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 27.11.2006, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga “Amal” sh.p.k. për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për periudhën 1 janar 2005 deri më 31 dhjetor 2005,

VENDOSI:

1.Çmimi i shitjes së energjisë elektrike të prodhuar nga “Amal” sh.p.k., për periudhën 1.1.2005-31.12.2005, të jetë 4.15 lekë/kwh.

2.Ngarkohet “Amal” sh.p.k. dhe KESH sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.82, datë 27.11.2006

**PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA “AMAL”
SHPK PËR PERIUDHËN 1 JANAR 2006 DERI NË 31 DHJETOR 2006**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 germa b, 9 dhe 26 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe vendimit nr.60, datë 29.12.2004 të Bordit të Komisionerëve “Për miratimin e të dhënave bazë në lidhje me aplikimin për çmimin e shitjes së energjisë elektrike nga prodhuesit e vegjël”, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 27.11.2006, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga “Amal” sh.p.k. për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për

periudhën 1 janar 2006 deri më 31 dhjetor 2006,

VENDOSI:

1. Çmimi i shitjes së energjisë elektrike të prodhuar nga “Amal” sh.p.k., për periudhën 1.1.2006-31.12.2006, të jetë 4.14 lekë/kwh.
2. Ngarkohet “Amal” sh.p.k. dhe KESH sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.83, datë 27.11.2006

**PËR LICENCIMIN E “ENERGO SAS” SHPK PËR NDËRTIMIN, INSTALIMIN DHE
PRODHIMIN E ENERGJISË NGA HEC SASAJ**

Në mbështetje të neneve 9, 13 pika 1 germa a, dhe 16 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, ndryshuar me ligjin nr.9512, datë 10.4.2006 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9072, datë 22.5.2003”, “Për sektorin e energjisë elektrike”, rregullores për procedurat e licencimit, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr.27, datë 30.5.2004, të ndryshuar, si dhe vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.51, datë 15.9.2006 “Për fillimin e procedurave të shqyrtimit”, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 27.11.2006, pasi shqyrtoi aprovimin nga shoqëria “Energo Sas” sh.p.k. për licencimin për aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe prodhimit të energjisë elektrike nga HEC Sasaj,

KONSTATON SE:

Nga tërësia e kërkesave të parashikuara në aktet e mësipërme “Energo Sas” sh.p.k. nuk ka plotësuar kushtin e marrjes së lejes së përdorimit të ujit dhe se nga dokumentacioni i dërguar në ERE rezultojnë se shoqëria është në proces të miratimit të dhënies së lejes së ujit nga Agjencia e Ujit Vlorë.

Përsa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë “Energo Sas” sh.p.k. për aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centralit elektrik dhe prodhimit të energjisë elektrike nga HEC Sasaj me afat 30 vjet.
2. Brenda afatit të përfundimit të punimeve të ndërtimit të HEC Sasaj, vënies në punë të tij dhe lidhjes me sistemin elektroenergjetik, “Energo Sas” sh.p.k. të pajiset dhe të paraqesë në ERE lejen e përdorimit të ujit.
3. Afati i fillimit të shfrytëzimit të HEC-it është data 1.3.2008.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

NDREQJE GABIMI

Në vendimin nr.703, datë 11.10.2006, botuar në Fletoren Zyrtare nr.116, shkronja “a” e pikës 2, kapitulli I

ishte:

a) privatizimin e ndërmarrjes ose të objekteve të veçanta, në zbatim të vendimit nr..., datë..., të Këshillit të Ministrave “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet, dhe procedurën e shitjes”.

bëhet:

a) privatizimin e ndërmarrjes ose të objekteve të veçanta, në zbatim të vendimit nr.704, datë 11.10.2006, të Këshillit të Ministrave “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet, dhe procedurën e shitjes”.

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 267 468
Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2006 është 18 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

- 1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
- 2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
- 3. REGJISTRAT E NOTERISË**
- 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:**

1. PËR PROKURIMIN PUBLIK (2006).....	1500
2. PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005)	600
3. PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë dhe vëllimi i II-të-2006).....	1300
4. PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT.....	500

Botime të reja

1 TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....	1000
2 TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500
3 TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....	1000
4 TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500
5 PËRMBLEDHJE MARRËVESHJESH NDERKOMBËTARE NË FUSHËN E DREJTËSISË.....	1000
6 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PUSHTETIN VENDOR.....	800
7 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NDËRTIMET.....	500
8 PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË (2000-2006).....	1000
...	
9 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQERITË TREGTARE.....	500

Hyri në shtyp më 11.12.2006
Doli nga shtypi më 11.12.2006

Tirazhi: 4000 copë	Formati: 60x88/8
---------------------------	-------------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2006

Çmimi 100 lekë